



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1088/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferid Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Malishevë, paraqitur kundër Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Subjektit Politikë Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Malishevë.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, ku pretenduesi ka theksuar se pas shpalljes së rezultateve zyrtare nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Konsideron se është dëmtuar për një anëtarë në Asamblenë Komunale pasi në vend të 8 anëtarëve në bazë të votave të fituara duhet të ketë 9 anëtarë. Pas publikimit të rezultateve vërehet se kandidatit Azem Gashi, i kandiduar nga dega e PDK –së i janë marrë apo humbur 95 vota pasi atij i janë publikuar 139 vota kurse në bazë të procesverbaleve të KQZ –së ai ka 234 vota.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar të subjektit politikë Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Malishevë pretendohet se ka manipulim me vota të rezultatit përfundimtar, parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova të mjaftueshme më të cilën do të vertetohej se është kryer një veprim i tillë, andaj një pretendim i tillë u vlerësua si i pabazuar dhe ne kuptim të nenit 3.6 pika c, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 1088 /2013 më datën 06.12.2013.



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.